



Zgjerimi i Komunitetit Tonë të Mësimdhënies

Të dashura Familje dhe Kolegë,

Shkollat e forta fillojnë me arsimtarë të fortë. Si Kancelar, dhe si dikush që e ka nisur karrierën e vet në New York City Public Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut) si [Mësues në NYC](#), e di sa transformues mund të jetë një mësues i shkëlqyer — për nxënësit, shkollat, dhe familjet.

Rekrutimi dhe mbështetja e arsimtarëve të shkëlqyer është thelbësore për të siguruar që çdo fëmijë, në çdo lagje, të ketë akses në arsim cilësor dhe që arsimtarët tanë të pasqyrojnë larminë dhe përsosmërinë e komuniteteve tona. Me ardhjen e klasave më të vogla në shkolla në të pesë bashkitë, ne po kërkojmë edhe më shumë banorë të Nju Jorkut që janë të pasionuar, të menduar, krijues, për t'u bërë mësues në NYCPS.

Pavarësisht nëse ju ose dikush që njihni është një mësues me përvojë ose po mendon mësimdhënien si një karrierë të re, NYC Public Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut) ofron shumë rrugë për të hyrë në këtë profesion. Këto përfshijnë mundësi për [mësues të certifikuar](#), mësues nga [shtete të tjera](#), [punonjës aktualë të NYCPS](#) që janë të interesuar të bëhen mësues, [rrugë të përshpejtuara](#) drejt mësimdhënies, mundësi

për [profesionistë nga industria](#), dhe të tjera. Mund të mësoni nëse këto mundësi janë të përshtatshme për ju ose për dikë që njihni në [TeachNYC.net](#).

Mësimdhënia në Qytetin e Nju Jorkut do të thotë të jesh pjesë e diçkaje më të madhe se çdo klasë e vetme. Është një mundësi për të shërbyer, për të mësuar dhe për të ndihmuar në formësimin e së ardhmes së qytetit tonë.

Nëse ju - ose dikush që njihni - e ka menduar ndonjëherë të bëhet arsimtar, ju inkurajoj të eksploroni dhe të shpërndani rrugët e disponueshme në [TeachNYC.net](#).

Në bashkëpunim,

Kamar H. Samuels

Kancelar

Fokusi i kancelares:

NYC Teaching Fellows (Mësuesit e NYC) është një rrugë që është veçanërisht e afërt për mua, pasi është programi në të cilin u bashkova mbi 20 vite më parë. Mësova për programin Teaching Fellows nga një reklamë në metro; ajo pyeste: “Do ta mbani mend gjithmonë emrin e mësueses tuaj të klasës së parë. Kush do ta mbajë mend emrin tuaj?” Kjo pyetje më mbeti në mendje. Aplikova për t’u bërë Teaching Fellow (Mësues) dhe disa muaj më vonë hyra në klasë.

Mësuesit tanë vijnë nga një gamë e gjerë sfondesh profesionale (unë isha duku punuar si kontabilist), dhe programi më ofroi përgatitje intensive, mentorim dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional për të më ndihmuar të zbatoja dashurinë time për matematikën në mësimdhënie.

[Aplikimi për programin NYC Teaching Fellows](#) është i hapur deri më 19 mars, ndaj sot është një ditë e shkëlqyer për të aplikuar nëse keni një diplomë bachelor dhe dëshirë për të bërë ndryshim në jetën e nxënësve të NYC.

[Propozoni një person ose program për The Chancellor’s Spotlight \(Në Fokus të Kancelarit\).](#)

Video përmbledhëse:



Për përkthime, ju lutemi vizitoni faqen [tonë në YouTube](#)

Për të aksesuar titrat e përkthyer: Klikoni mbi ikonën “CC”. Klikoni mbi ikonën “Settings (Cilësimet)” dhe zgjidhni “Subtitles/CC (Titrat/CC)”. Zgjidhni “Auto Translate (Përkthim Automatik)” dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajme dhe burime nga NYCPS-ja:

- Janari shënoi për herë të parë Muajin e Trashëgimisë Myslimano-Amerikane në Shtetin e Nju Jorkut. Shikoni [burimin tonë mësimor “Hidden Voices \(Zëra të Fshehur\)”](#), i cili feston amerikanët myslimanë që kanë ndikuar në qytetin tonë, vendin tonë dhe botën.
- Shkurti është Muaji i Historisë së të Zinjve (Black History Month.). Vizitoni [faqen tonë zyrtare për Black History Month](#) për listën e përditësuar të eventeve tematike, ekspozitave, rekomandimeve të librave dhe burimeve audiovizive për familjet dhe arsimtarët.
- Për të reja dhe burime të tjera, ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#), dhe [YouTube](#).

Familje të NYCPS-së: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, ju lutemi [çabonohuni \(unsubscribe\)](#).

